



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1724/6 Prot

Tiranë, më 11 . 12 .2023

VENDIM

Nr. 59, datë 11. 12.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1724 Prot., datë 25.10.2023, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër Sh.A.” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në cilësinë e kërkuarit, ankuesi, nëpërmjet shkresës datë 04.10.2023, depozituar në adresën elektronike ukdibersha@gmail.com, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni si vijon:

1. *Dokumentacionin për procedurën tenderuese me objekt: “Implementimi dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit, migrimi i të dhënave ofrimi shërbimit dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit” të zhvilluar nga shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Dibër SH.A*
2. *Bazuar në ligjin “Për Prokurimin Publik”, neni 34, dokumentacionin me metodën e llogaritjes së vlerës së fondit limit.*
3. *Nëse ka një dokument studimi paraprak të tregut, për këtë objekt tenderimi.*

4. *Kontratat e mëparshme të zhvilluar nga ish-ujësjellësat e Dibrës, Bulqizës, Klosit dhe Matit, sot nën administrimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër S.H.A, me objekt: Sistemet e faturimit ose të mirëmbajtjes së sistemeve të faturimit, me dokumentacionin përkatës prokurues dhe vlerat financiare të investuar. Kjo për harkun Kohor 2015-2022.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeht ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit. Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 1724/1 prot., datë 26.10.2023 kërkoi nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion si dhe sqarime për zotërimin e dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 01.11.2023.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1112/1 Prot., datë 31.10.2023, regjistruar me nr. 1724/2 Prot., datë 02.11.2023, sqaron Komisionerin se: “*...Nuk është paraqitur asnjë ankesë zyrtare me shkrim pranë Autoritetit Publik, Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a. Për sa i përket përmbajtjes së kërkesës që na keni sjellë bashkëlidhur shkresën nr. 1724 Prot., datë 25.10.2023, po ju paraqesim disa parashtrime si më poshtë:*

1. *Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, kërkuesi (personi) duhet të legjitimohet si entitet juridik ose si punonjës i këtij entiteti juridik, pasi në gjykimin tonë ekziston rreziku që këto të dhëna sensitive personale të keqpërdoren në rastet kur këto të dhëna posedohen nga entitete, të cilët merren me veprimtari të jashtëligjshme të llojit: disinformim, shpifje, shantazhe etj...*
2. *Përsëri në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 3 pika 7, entiteti që paraqet kërkesën duhet të dëshmojë se përmbush kushtet si më poshtë:*
 - *Të jetë çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative,*
 - *Ose një palë që nuk ka interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të çenohen nga rezultati i procedurës.*
3. *Gjithashtu, kërkuesi duhet të marrë në konsideratë parashikimet e nenit 44 pika 2 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ku parashikohet se: “Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me*

përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji”. Kërkesa (në rastin tonë) siç e kemi përmendur dhe më sipër rezulton se nuk ka mbërritur pranë organit publik (Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a.) Për sa më sipër, me paraqitjen e kërkesës zyrtare dhe njëkohësisht me përmbushjen e kërkesave ligjore të lartpërmendura, do të veprojmë në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.”

Për sa më sipër, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 14.11.2023, me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesëve të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qendrimin e reflektuar në ankesë, duke kërkuar vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës, sipas kërkesës për informacion datë 04.10.2023.

Ndërkohë, drejtuesi i seancës dëgjimore të Komisionerit, nisur nga përgjigja zyrtare me nr.1112/1 Prot., datë 31.10.2023, rikonfirmuar me shkresën nr. 1139/1 Prot., datë 06.11.2023, solli në vëmendje të përfaqësuesëve të Autoritetit Publik, procedurën e trajtimit të kërkesave për informacion në raport me LDI, si legjislacioni specifik që rregullon të drejtën për informim. Këta të fundit, pasi u informuan me detyrimet që burojnë nga LDI, morën përsipër të rivlerësojnë kërkesën për informacion brenda datës 17.11.2023.

Në këto kushte, Autoriteti Publik me shkresën nr. 1189 Prot., datë 16.11.2023, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 1724/6 Prot., datë 17.11.2023, ka kthyer përgjigje për disa kërkesa për informacion duke i shoqëruar ato me disa dokumenta. Gjithashtu, në pjesën për të cilën ka dhënë shpjegim për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, ka sqaruar se informacioni që lidhet me prokurimet mund të gjendet në faqen zyrtare të Sistemit të Prokurimit Elektronik (APP) pa pasur nevojë për autorizim apo llogari përdoruesi, pasi ky informacion është publik dhe lehtësisht i aksesueshëm.

Këtë shkresë, sëbashku me dokumentet shoqëruese, Komisioneri e vendosi në dispozicion të ankuesit, si subjekt i interesuar për këtë procedurë.

Në vijim, ankuesi me e-mail-in datë 23.11.2023, regjistruar pranë Komisionerit me nr.1724/7 Prot., datë 23.11.2023, ka vijuar me ankimin me pretendimin se: “...nga vlerësimi i informacionit të sjellë, në asnjë faqe, nuk gjenden të dhëna për procesverbalet e shpalljes së fituesit. Janë skanuar vetëm formularët tip miratuar nga APP për prokurimin përkatës të cituar në fillim. Gjithashtu, nuk ka informacion për llogaritjen e vlerës së fondit limit dhe kontratat e mëparshme.”

Për sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se përgjigja e vendosur në dispozicion nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me kërkesën për informacion datë 04.10.2023.

Autoriteti Publik në përgjigjen me nr. 1724/6 Prot., datë 17.11.2023, nuk ka dhënë asnjë shpjegim lidhur me tenderin “*Implementimi dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit, migrimi i të dhënave ofrimi shërbimit dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit*”, apo “*Sistemet e faturimit ose të mirëmbajtjes së sistemeve të faturimit*”, objekt ankese, por, në rubrikën ku sqaron për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, citon se informacioni që lidhet me prokurimet mund të gjendet në faqen zyrtare të Sistemit të Prokurimit Elektronik (APP) pa pasur nevojë për autorizim apo llogari përdoruesi, pasi ky informacion është publik dhe lehtësisht i aksesueshëm.

Ndërkohë, nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur rezulton se Autoriteti Publik ka vendosur në dispozicion vetëm dokumentat standarde të tenderit për procedurën e hapur, me objekt “*Përditësim i Programit të Faturimit, migrim i të dhënave dhe web-service për pagesat e faturat e ujit të pijshëm*”. Dokumentacion ky i cili nuk e përmbush detyrimin për informim sipas pikave të kërkesës për informacion datë 27.09.2023.

Ndërkohë, Komisioneri vlerëson se, një pjesë e informacionit të kërkuar në pikën 1 dhe 4 të kërkesës për informacion, bën pjesë në atë kategori informacioni, që duhet të bëhet publik pa kërkesë. Konkretisht, sipas pikës ë) të nenit 7 të LDI, çdo autoritet publik, duhet të ketë publik në programin e transparencës *informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, që kryhen për llogari të autoritetit publik privat, duke përfshirë:*

- i. listën e kontratave të lidhura;*
- ii. shumën e kontraktuar;*
- iii. palët kontraktuese dhe përkrahimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;*
- iv. informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.*

Nga sa më sipër, Autoriteti Publik jo vetëm duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, por në zbatim të nenit 7 të LDI, duhet që një pjesë të informacionit të kërkuar t’u kishte bërë publik në mënyrë proaktive në programin institucional të transparencës.

Ndërkohë, pjesa tjetër e kërkesës për informacion, përfshihet në ato kategori informacioni që vendoset në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar, në përputhje kjo me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI. Detyrim ky i pa përmbushur nga Autoriteti Publik.

Për sa i përket faqes së referuar nga Autoriteti Publik, konkretisht atë të Sistemit të Prokurimit Publik, në të cilën pretendohet se është publikuar informacioni i kërkuar, Komisioneri konstaton se, autoriteti ka referuar vetëm faqen zyrtare të institucionit dhe jo adresën e saktë të saj, ku informacioni mund të gjendet lehtësisht nga kërkuesi.

Ky qëndrim i Autoritetit Publik vjen në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të nenit 16 të LDI, në të cilën parashikohet se: *“Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni...”*. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar, duhet t’i tregojë ankuesit adresën e saktë në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në të cilën pretendon se gjendet informacioni i kërkuar.

Komisioneri thekson se, në pikën 1 të nenit 2 të LDI, përcaktohet se, *“Autoritet publik”*: ... b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Nga verifikimi i kryer në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, rezulton se, Ujësjetës Kanalizime Dibër sh.a., (në vijim “UKD sh.a.”), është shoqëri aksionere, me pjesëmarrje të aksioneve 51 % Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, 18.80 % Bashkia Dibër, Bashkia Bulqizë 12.18 %, 4.16 % Bashkia Klos dhe 13.86 % Bashkia Mat. Pra, nga sa më sipër, rezulton se UKD sh.a. është një shoqëri tregëtare me aksione publike, që ushtron funksione publike, me objekt të veprimtarisë së saj përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Për rrjedhojë, UKD sh.a. është Autoritet Publik në kuptim të LDI dhe detyrohet për zbatimin e tij.

Për të munduruar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Gjithashtu, në pikën 1 të nenit 3, LDI, përcakton se: *“1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.”*

Bazuar në këto parashikime, Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik është i detyruar të zbatojë detyrimet e LDI ndërsa, përgjegjësia për tjetërsimin e informacioneve bie mbi individin që merr apo përdor këtë të fundit. Në rast keqpërdorimi të informacionit publik nga ana e kërkuesit, Autoriteti Publik ka instrumentet ligjore të vëna në dispozicion nga legjislacioni në fuqi.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, duke qenë se kërkesa për informacion konsiston në vënien në dispozicion të prokurimeve të realizuara nga Ujësjetës Kanalizimeve Dibër sh.a., dhe lidhet me menaxhimin e fondeve publike, rrjedhimisht ky informacion/dokumentacion përbën një interes të lartë për publikun.

Në këto kushte, dokumentacioni i kërkuar në kërkesën për informacion datë 27.09.2023, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Bazuar në këtë dispozitë, Autoriteti Publik, duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit/ankuesit informacionin e zotëruar në lidhje me këtë kërkesë, në përputhje me nenin 17 të LDI.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1724 Prot., datë 25.10.2023, nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër Sh.A.”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 04.10.2023, konkretisht: (1. *“Dokumentacionin për procedurën tenderuese me objekt: “Implementimi dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit, migrimi i të dhënave ofrimi shërbimit dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit” të zhvilluar nga shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër SH.A.* 2. Bazuar në ligjin “Për Prokurimin Publik”, neni 34, dokumentacionin me metodën e llogaritjes së vlerës së fondit limit. 3. Nëse ka një dokument studimi paraprak të tregut, për këtë objekt tenderimi. 4. Kontratat e mëparshme të zhvilluar nga ish-ujësjellësat e Dibrës, Bulqizës, Klosit dhe Matit, sot nën administrimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër SH.A, me objekt: Sistemet e faturimit ose të mirëmbajtjes së sistemeve të faturimit, me dokumentacionin përkatës prokurues dhe vlerat financiare të investuar. Kjo për harkun Kohor 2015-2022.), duke respektuar kufizimet, në

përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, brenda datës 18. 12. 2023.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 11. 12. 2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi